



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.116**

**8 shtator**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM  
nr.525, datë 8.8.2007

Për identifikimin e koncesionit për projektin “Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit dhe pasaportave elektronike”, për përcaktimin e autoritetit kontraktues dhe për një ndryshim në vendimin nr.196, datë 13.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektit “Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit dhe pasaportave elektronike të shtetasve shqiptarë” dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Brendshme”.....

3317

Vendim i KM  
nr.529, datë 15.8.2007

Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit.....

3317

Vendim i KM  
nr.530, datë 15.8.2007

Për miratimin, në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për statusin e forcave ushtarake shqiptare.....

3321

Vendim i KM  
nr.533, datë 22.8.2007

Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Steblevë”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....

3325

Vendim i KM  
nr.534, datë 22.8.2007

Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Darsi”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..

3325

|                                       |                                                                                                                                                                                                                                          |      |
|---------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i KM<br>nr.535, datë 22.8.2007 | Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Prellë”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..                                                  | 3326 |
| Vendim i KM<br>nr.536, datë 22.8.2007 | Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit për dhënien me qira, me çmimin simbolik një euro, të sipërfaqes 14 600 m <sup>2</sup> , të uzinës së vjetër të uresë, për ndërtimin e një termocentrali.....                                  | 3326 |
| Vendim i KM<br>nr.537, datë 1.8.2007  | Për rregullat për emrat dhe emërtimet tregtare.....                                                                                                                                                                                      | 3327 |
| Vendim i KM<br>nr.541, datë 22.8.2007 | Për përcaktimin e procedurave të kalimit në pronësi të trojeve, mbi të cilat janë bërë ndërtime të ligjshme, para datës 10.8.1991 dhe të sipërfaqeve, në dokumentin e pronësisë së të cilave është bërë shënimi “Oborr në përdorim”..... | 3331 |

**VENDIM**  
**Nr.525, datë 8.8.2007**

**PËR IDENTIFIKIMIN E KONCESIONIT PËR PROJEKTIN “PRODHIMI DHE SHPËRNDARJA E DOKUMENTIT TË IDENTITETIT DHE PASAPORTAVE ELEKTRONIKE”, PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.196, DATË 13.4.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “PRODHIMI DHE SHPËRNDARJA E DOKUMENTIT TË IDENTITETIT DHE PASAPORTAVE ELEKTRONIKE TË SHTETASVE SHQIPTARË” DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BRENDSHME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 5 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Identifikimin e koncesionit për projektin “Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit dhe pasaportave elektronike”, në formën e propozimit të kërkuar.
2. Përcaktimin e Ministrisë së Brendshme si autoritetin kontraktues, për këtë projekt.
3. Pikat 2 dhe 3 të vendimit nr.196, datë 13.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektit “Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit dhe pasaportave elektronike të shtetasve shqiptarë” dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Brendshme”, shfuqizohen.
4. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.529, datë 15.8.2007**

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË APLIKIMIT E TË MIRATIMIT TË LEJEVE TË NDËRTIMIT TË LINJAVE TREGTARE TË INTERKONJEKSIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.9776, datë 12.7.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kriterëve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

## KRITERET DHE PROCEDURAT PËR APLIKIMIN DHE MIRATIMIN E LEJEVE PËR NDËRTIMIN E LINJAVE TREGTARE TË INTERKONJEKSIONIT

### **1. Fusha e zbatimit dhe dispozita të përgjithshme**

1.1 Këshilli i Ministrave miraton ndërtimin e linjave tregtare të interkonjeksionit, duke përjashtuar nga aplikimi i “së drejtës për akses të palëve të treta” mbi këtë linjë.

1.2 Objekt i normave janë linjat e interkonjeksionit me tension më të lartë ose të barabartë me 110 kV, të cilat u përkasin rrjeteve elektrike të vendeve të ndryshme.

1.3 Nuk pranohen kërkesat për përjashtim nga aplikimi i “së drejtës për akses të palëve të treta” për linjat e interkonjeksionit, të vlerësuara si dublikime funksionale të këtyre linjave, në realizim e sipër nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) ose ato të përfshira në planin e zhvillimit të rrjetit kombëtar të transmetimit, që nuk janë shtyrë për t’u realizuar gjatë katër viteve nga data e futjes së parë, përveç kur në mënyrë eksplicite u është refuzuar nga OST sh.a.-ja.

1.4 OST sh.a.-ja, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe në vazhdim, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, në bazë të aseteve ekzistuese të rrjetit kombëtar të transmetimit, tregon kapacitetin, për të cilin mund të jepet leja, gjatë vitit pasardhës, pa cenuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e funksionimit të sistemit elektroenergjetik kombëtar, si dhe përcakton ndarjen e këtij kapaciteti, sipas kufijve të ndryshëm, për të orientuar zgjedhjen e subjekteve kërkuese, të mundshme.

### **2. Kriteret për marrjen e lejes për linjat e interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar**

2.1 Subjektet e palicencuara për të ushtruar veprimtari transmetimi ose shpërndarjeje të energjisë elektrike, por që duan të realizojnë, me shpenzimet e veta, linja të reja tregtare interkonjeksioni, me sistemet elektrike të transmetimit të shteteve të tjera, me rrymë të vazhduar ose teknologji ekuivalente, paraqesin në ministrinë përgjegjëse për energjinë (më poshtë “Ministria”) kërkesën për leje, për përjashtimin nga rregullat e aplikimit të “së drejtës për akses të palëve të treta” (më poshtë “Leja”).

2.2 Njohja e teknologjisë ekuivalente është përgjegjësi e ministrisë, pas mendimit të argumentuar të OST sh.a.-së.

2.3 Kërkesa për leje, e përcaktuar në pikën 2.1, duhet t’i takojë një linje elektrike interkonjeksioni me jashtë, për të dyja drejtimet e flukseve të energjisë. Në kërkesën për leje, subjekti kërkuar paraqet bashkëlidhur edhe këto të dhëna:

a) datën e parashikuar për fillimin e punimeve dhe datën e vënies në shfrytëzim të linjës së interkonjeksionit;

b) karakteristikat kryesore teknike të linjës së interkonjeksionit, përfshirë edhe vendet e parashikuara për lidhjen e linjës me sistemin elektrik të transmetimit kombëtar dhe me rrjetin e transmetimit të vendeve fqinje, për të cilat është rënë dakord me administratorët e rrjeteve të interesuara;

c) kapacitetin neto të transmetimit, që ai kërkon, në raport me kapacitetin e përgjithshëm të linjës së interkonjeksionit, si dhe duke përcaktuar qartë vitet për të cilat kërkohet leja, duke argumentuar se moslëshimi i lejes në afatet e kërkuara, do ta bënte realizimin e linjës së interkonjeksionit ekonomikisht joefektiv;

ç) analizën, ekonomike dhe financiare, të linjës së interkonjeksionit, duke marrë parasysh risqet e mundshme të investimit dhe mënyrat e zbatuara për mbulimin e kostove të nevojshme, për ndërtimin e këtyre linjave;

d) angazhimin për të respektuar, gjatë gjithë periudhës së ndërtimit dhe të funksionimit të linjave të interkonjeksionit, parashikimet e kodit të transmetimit, si dhe çdo rregull tjetër teknik të OST sh.a.-së për të garantuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e funksionimit të sistemit elektroenergjetik kombëtar;

dh) angazhimin për të filluar punimet në kohën e parashikuar;

e) angazhimin për të realizuar linjën e interkonjeksionit brenda afateve dhe kushteve të parashikuara në projektin paraprak, që i bashkëlidhet kërkesës, përveç rasteve të motivuara paraprakisht, të autorizuara;

ë) angazhimin, që edhe në një situatë kapacitetesh të limituara (congestion) të interkonjeksioneve, do t’i sigurojë falas OST sh.a.-së, kuotën e kapacitetit, për të cilën nuk i është dhënë përjashtimi nga aplikimi i lejes;

f) kalimin në pronësi të OST sh.a.-së të aseteve, në përfundim të periudhës së lejes.

2.4 Kërkesës për leje, përveç projektit paraprak, i bashkëlidhen fotokopje të noterizuara të të gjitha autorizimeve paraprake, të lëshuara për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjave të interkonjeksionit, në territorin e huaj.

2.5 Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, ministria i kërkon subjektit ta plotësojë brenda 60 ditëve. Kur edhe me mbarimin e afatit, dokumentacioni nuk është i plotë, kërkesa quhet e refuzuar.

### **3. Kriteret për marrjen e lejes për linjat e interkonjeksionit me rrymë alternative**

3.1 Subjektet e palicencuara për të ushtruar veprimtari transmetimi ose të shpërndarjes së energjisë elektrike, që duan t'i realizojnë, me shpenzimet e veta, linjat e reja tregtare të interkonjeksionit, me sistemet elektrike të shteteve të tjera, me rrymë alternative, paraqesin kërkesën për leje në ministri, në atë mënyrë siç është parashikuar në pikat 2.3 e 2.4, së bashku me:

a) dokumentacionin, për të provuar se kostoja dhe risqet e investimeve, për realizimin e linjave të interkonjeksionit janë veçanërisht të larta, krahasuar me kostot dhe risqet normale, në çastin e lidhjes së dy sistemeve të transmetimit kombëtar kufitar, nëpërmjet një linje interkonjeksioni, me rrymë alternative;

b) deklarin e angazhimit për të kërkuar përfshirjen e linjës së interkonjeksionit, pavarësisht nga niveli i tensionit, në rrjetin e transmetimit kombëtar, nga data e fillimit të shfrytëzimit, si dhe të lidhë marrëveshje me OST sh.a.-në, për të rregulluar veprimtarinë e funksionimit dhe të mirëmbajtjes së linjës.

3.2 Në rastet kur kërkesat nuk janë të plota, veprohet në përputhje me pikën 2.5.

### **4. Kriteret dhe procedurat për lëshimin e lejes**

4.1 Kërkesat për marrjen e lejes sipas pikave 2 e 3 shqyrtohen nga ministria, duke pasur parasysh elementet vlerësuese, të paraqitura nga kërkuesi, dhe çdo informacion ose element, të gjykuar të nevojshëm, duke vendosur, rast pas rasti, dhënien e lejes, nëse plotësohen këto kritere:

a) vënia në punë e linjës së re të interkonjeksionit të garantojë kërkesat e sigurisë, të qëndrueshmërisë dhe të funksionimit efikas të sistemit elektrik të transmetimit kombëtar;

b) vënia në punë e linjës së re të interkonjeksionit, duke pasur parasysh konfigurimin e të dyja sistemeve kombëtare të transmetimit dhe të ndërhyrjeve, të rrisë kapacitetet tregtare të importimit ose eksportimit të energjisë elektrike;

c) vënia në punë e linjës së re të interkonjeksionit të nxisë konkurrencën në ofrimin e energjisë elektrike në treg;

ç) risqet e lidhura me investimin të jenë në masën që të mos rrezikojnë investimin, edhe nëse nuk jepet leja;

d) të jetë arritur një marrëveshje paraprake, ndërmjet ministrisë dhe autoriteteve kompetente të shtetit të interesuar, për mënyrat e aksesit apo të përdorimit të linjës së interkonjeksionit;

dh) verifikimi i përputhshmërisë teknike të linjës së interkonjeksionit, në kuadër të sigurimit dhe të qëndrueshmërisë së funksionimit të sistemit elektroenergjetik kombëtar dhe të linjave të interkonjeksionit të jetë, pozitiv;

Për këtë qëllim është e nevojshme që subjekti, i cili kërkon leje, të ketë marrë paraprakisht mendimin me shkrim OST sh.a.-së, për koherencën e linjës së interkonjeksionit me zhvillimet e rrjetit kombëtar dhe të administratorit të rrjetit të vendit tjetër.

e) kapaciteti transmetues, i përcaktuar në lejen e dhënë për linjën e interkonjeksionit dhe kapaciteti i dhënë për linja të tjera interkonjeksioni, të mos jetë më i madh se kapaciteti total, maksimal, i transmetimit, i përcaktuar në pikën 4.2.

4.2 Për periudhën deri më 31 dhjetor 2012 kapaciteti total, maksimal, i transportit për të cilën mund të jepet leje, është i përcaktuar në 2000 MW për linjat e interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar dhe në 1000 MW, për kapacitetin neto të transportit (*Net transfer capacity*) për linjat e interkonjeksionit, me rrymë alternative. Për përmirësimin e sigurisë dhe të qëndrueshmërisë së sistemit elektrik, si dhe për nxitjen e konkurrencës në tregun e ofertave të energjisë elektrike nuk mund të jepet, si rregull, leja për një kapacitet transporti më të madh se 1200 MW dhe vetëm për një linjë interkonjeksioni.

4.3 Ministria vendos dhënien e lejes brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës, pasi të ketë marrë mendimin e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, si dhe OST sh.a.-së, si dhe pas këshillimeve me përfaqësuesit apo autoritetin rregullator, siç përcaktohet në shkronjën "d" të pikës 1.

4.4 Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe OST sh.a.-ja, duhet të shprehen, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e kërkesës.

4.5 Në rast se ministria arrin në përfundimin se duhet dhënë leja, lëshon një leje, të plotë ose të kushtëzuar, të shoqëruar me qëndrimin e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike. Në rast të refuzimit ose të shtyrjes, ministria shpjegon arsyet.

4.6 Leja e dhënë nga ministria hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenet 31 e 31/1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe pasi të jenë lidhur kontratat përkatëse, që parashikohen në lejen e dhënë nga ministria.

4.7 Leja e dhënë nga ministria përmban edhe detyrimet, që duhet të respektojë kërkuesi për:

i) realizimin e investimeve në rrjetin ekzistues të transmetimit, që duhen bërë për shkak të realizimit të linjës tregtare të interkonjeksionit dhe që do të jenë pjesë e rrjetit kombëtar të transmetimit, në pronësi të OST sh.a.-së;

ii) garancitë financiare, që duhet të dorëzojë kërkuesi dhe kohën brenda së cilës këto garanci duhet të dorëzohen;

iii) rastet e revokimit të lejes, përpara përfundimit të kohës, dhe shkaqet e këtij revokimi.

4.8 Për linjat e interkonjeksionit me rrymë alternative, leja jepet sipas të njëjtave kritere dhe kushte, të parashikuara në pikat e mësipërme, por me kusht që mbajtësi i lejes t’i garantojë OST sh.a.-së, vënien në dispozicion të linjës së interkonjeksionit në rastet e emergjencës, për ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit elektroenergetik, dhe që linja e interkonjeksionit, për të cilën jepet leja, të pajiset me dispozitiv rregullues të fluksit të fuqisë, si dhe me transformator variues të fazës.

## **5. Përmbajtja e lejes dhe detyrimet e mbajtësit të saj**

5.1 Me qëllim lidhjen e sistemit kombëtar elektrik, menaxhimin e tij dhe pjesëmarrjen në tregun elektrik, për linjën e interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar ose me teknologji ekuivalente, zbatohen të njëjtat rregulla si për centralin e prodhimit të energjisë, duke vlerësuar karakteristikat teknike të veçanta për këtë impiant. Në veçanti, aksesit i energjisë së importuar nga sistemi elektrik kombëtar realizohet në koherencë me operatorët e tjerë, që kërkojnë akses në të njëjtin sistem, në bazë të rregullave të dispeçerimit.

5.2 Nëse leja jepet për një pjesë të kapacitetit të transmetimit, ajo llogaritet mbi kapacitetin neto, efektivisht të disponueshëm gjatë vënies në punë, dhe përcaktohet në bazë orare. Pjesa e mbetur, në çdo orë, mbetet në dispozicion të operatorit të rrjetit.

5.3 Nëse subjekti mbajtës i lejes nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në shkronjën “dh” të pikës 2.3, për datën e fillimit të punimeve dhe për komunikimin e rasteve të vonesave të mundshme e të motivuara, apo nuk përmbush detyrimin e shkronjës “e” të pikës 2.3, për kohën dhe kushtet për realizimin sipas autorizimit dhe shtyrjeve të mundshme të afatit, leja revokohet.

5.4 Nëse subjekti, mbajtës i lejes, nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në shkronjat “d”, “ë” dhe “f” të pikës 2.3, si dhe nuk merr masat e menjëhershme për sigurimin e sistemit elektrik kombëtar, ministria i jep 30 ditë kohë për të përmbushur detyrimet. Në të kundërt, i revokohet leja e dhënë.

## **6. Variantet e projektit, shtyrja e afateve, modifikimet e të drejtave**

6.1 Subjekti mbajtës i lejes i komunikon, paraprakisht, ministrisë dhe OST sh.a.-së variantet e mundshme të projektit të linjës së re të interkonjeksionit, të nevojshme gjatë punës dhe që parashikojnë një modifikim të kapacitetit të transmetimit, jo më të madh se 5% të vlerës së parashikuar dhe të funksionimit të linjës, edhe duke iu referuar pikave të lidhjes në rrjet.

6.2 OST sh.a.-ja, brenda 30 ditëve nga marrja e të dhënave, të përcaktuara në pikën 6.1 i paraqet mendimet e veta në ministri, e cila brenda 30 ditëve, i komunikon mbajtësit të lejes udhëzimet e nevojshme.

6.3 Për variantet, që parashikojnë një modifikim të kapacitetit të transmetimit, më shumë se 5% të funksionimit të linjës, edhe duke iu referuar pikave të lidhjes në rrjet, subjekti mbajtës i lejes është i detyruar të paraqesë një kërkesë, në përputhje me pikat 2 dhe 3. Ministria do të nisë një procedurë të re të vlerësimit dhe mund të revokojë lejen e dhënë më përpara, nëse variantet sjellin modifikime domethënëse në asete dhe në funksionimin e sistemit elektrik, në përputhje me sa është parashikuar në çastin e dhënies së lejes.

6.4 Subjekti mbajtës i lejes mund t’i kërkojë ministrisë shtyrjen e afateve të caktuara, në shkronjat “dh” dhe “e” të pikës 2.3. Ministria, për këto kërkesa, shprehet brenda një afati kohor, 60 ditë nga marrja e kërkesës, duke marrë parasysh edhe mendimin e OST sh.a.-së.

#### **7. Marrëveshja me OST sh.a.-në**

Mbajtësi i lejes, përpara fillimit të punimeve, lidh një kontratë me OST sh.a.-në, për mënyrën e ndërtimit dhe të funksionimit të linjës tregtare të interkonjeksionit.

8. Për çdo gjë të pashprehur në këtë tekst do të zbatohen rregullat përkatëse, që rregullojnë marrëdhëniet në sektorin elektroenergjetik.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

#### **VENDIM Nr.530, datë 15.8.2007**

#### **PËR MIRATIMIN, NË PARIM TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE, PËR STATUSIN E FORCAVE USHTARAKE SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

Miratimin, në parim të Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për statusin e forcave ushtarake shqiptare.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

#### **MARRËVESHJE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE MBI STATUSIN E FORCAVE USHTARAKE SHQIPTARE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe, këtu të quajtura “Palë”:

*duke pasur parasysh* zhvillimin e marrëdhënieve ekzistuese miqësore mes dy vendeve, bazuar në parimet e reciprocitetit dhe interesit të përbashkët,

*bazuar në miratimin* që qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe ka dhënë për vendosjen e trupave ushtarake shqiptare pjesëmarrëse në koalicionin e luftës kundër terrorizmit në territorin e Emirateve të Bashkuara Arabe,

kanë rënë dakord si më poshtë:

#### **Neni 1**

Qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe bie dakord që të pranojë në territorin e saj forcat ushtarake shqiptare, të cilat do të jenë pjesëmarrëse në misionet e ndryshme në mbështetje të paqes.

#### **Neni 2**

Forcë ushtarake shqiptare nënkupton çdo njësi, kontingjent apo pjesë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilat me miratimin e Qeverisë së shtetit të Emirateve të Bashkuara Arabe ndodhen legalisht në këtë shtet dhe që përfshijnë çdo punonjës civil të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të dërguar në Emiratet e Bashkuara Arabe në lidhje me këtë Marrëveshje.

### Neni 3

Forca ushtarake shqiptare do të respektojë ligjet, rregullat, zakonet dhe traditat e aplikuara në Emiratet e Bashkuara Arabe, për sa kohë që respektimi i këtyre ligjeve pajtohet me detyrat, mandatin e ngarkuar dhe do të shmangë çdo aktivitet që nuk pajtohet me natyrën e operacionit.

### Neni 4

Personeli i forcave ushtarake shqiptare do të mbajë normalisht uniformë dhe mund të zotërojë ose mbajë armë, nëse janë të autorizuar për këtë me urdhër të tyre. Autoritetet e Emirateve të Bashkuara Arabe do të pranojnë si të vlefshme, pa taksa ose shpenzime, patentat për drejtimin e automjeteve dhe lejet e lëshuara personelit të forcave ushtarake shqiptare nga autoritetet respektive kombëtare.

### Neni 5

Personelit të forcave ushtarake të Republikës së Shqipërisë do t'i jepen nga shteti i Emirateve të Bashkuara Arabe privilegjet dhe imunitetet e stafit administrativ dhe teknik, në përputhje me konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të 18 prillit 1961.

### Neni 6

Forcat ushtarake të Republikës së Shqipërisë do të lejohen të ekspozojnë flamurin e Republikës së Shqipërisë mbi çdo uniformë të tyre, mjete transporti dhe pajisje.

### Neni 7

Ushtarakët e forcës shqiptare mund të zotërojnë dhe të mbajnë çdo lloj arme, kur autorizohen të veprojnë kështu në bazë të urdhrave, që do të marrin gjatë kryerjes së detyrave të tyre operacionale.

### Neni 8

Republika e Shqipërisë do të ketë imunitet nga të gjitha proceset juridike, qofshin ato civile, administrative ose penale që shkaktohen nga çdo akt dhe/ose gabim brenda territorit të Emirateve të Bashkuara Arabe.

Personeli i forcave ushtarake të Republikës së Shqipërisë në çdo rrethanë dhe kohë do të jetë subjekt, ekskluzivisht, i elementeve të juridiksionit të autoriteteve të tyre respektive kombëtare për shkeljet civile, administrative, penale ose disiplinore, të cilat mund të kryhen nga ana e tyre në Emiratet e Bashkuara Arabe. Autoritetet e Emirateve të Bashkuara Arabe do të ofrojnë asistencën e tyre për ushtrimin e juridiksionit ndaj shtetasve të vet.

Republika e Shqipërisë gëzon të drejtën të heqë dorë nga juridiksioni i vet për çdo/dhe të gjitha shkeljet e kryera në Emiratet e Bashkuara Arabe në favor të autoriteteve të Emirateve të Bashkuara Arabe, me përjashtim të shkeljeve që kanë të bëjnë me personelin kontaktues, të cilët nuk i nënshtrohen juridiksionit të vendeve të nënshtetësisë së tyre dhe vetëm pas konsultimit me vendin e nënshtetësisë së personelit kontaktues.

Kontraktuesit, personeli i kompanive dhe shtetasit e Emirateve të Bashkuara Arabe që do t'u bashkohen Forcave Ushtarake Shqiptare, janë nën juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të Emirateve të Bashkuara Arabe, përsa u përket çështjeve civile dhe penale.

### Neni 9

Personeli i forcave ushtarake të Republikës së Shqipërisë do të ketë imunitet nga çdo lloj forme arrestimi, hetimi ose burgimi nga ana e autoriteteve të Emirateve të Bashkuara Arabe. Personeli shqiptar, i arrestuar gabimisht, do t'u kthehet menjëherë autoriteteve të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 10

a) Secila palë heq dorë nga çdo pretendim që ka apo mund të ketë ndaj qeverisë tjetër ose ndaj çdo personeli të forcës së qeverisë tjetër lidhur me dëmtime (përfshirë dëmtime që rezultojnë në vdekje) të pësura nga personeli i saj apo lidhur me dëmtimin ose humbjen e pasurisë së saj, nëse dëmtimi, vdekja, plagosja apo humbja e pasurisë shkaktohet nga veprime apo neglizhime të personelit të qeverisë tjetër në përmbushjen e detyrave zyrtare në lidhje me këtë Marrëveshje.

b) Forca shqiptare do t'ia dorëzojë pajisjet dhe ndërtesat, të vëna në dispozicion të saj, Emirateve të Bashkuara Arabe në të njëjtën gjendje si në kohën e marrjes së tyre në dorëzim. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do t'i paguajë Emirateve të Bashkuara Arabe një kompensim të merituar dhe të arsyeshëm për çdo dëmtim apo humbje, që pas hetimit rezulton se ka ardhur si rrjedhojë e keqpërdorimit të tyre.

c) Qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe, në përputhje me të gjitha ligjet e saj, do të shqyrtojë dhe zgjidhë pretendimet e palëve të treta, që lindin brenda territorit të saj.

d) Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përpiqet të asistojë në lidhje me pretendimet e palëve të treta, që rrjedhin si pasojë e ndonjë veprimi apo neglizhimi të çdo personeli të forcës shqiptare që shkakton dëmtim, përveç rasteve kur forca shqiptare kryen detyra zyrtare në bazë të kësaj Marrëveshjeje, si dhe sigurimin e përmbushjes së çdo vendimi të marrë në lidhje me pretendime të tilla.

#### Neni 11

Forca ushtarake shqiptare mund të hyjë dhe të dalë nga Emiratet e Bashkuara Arabe me karta identiteti ushtarake apo dokument identifikimi të vlefshëm për udhëtim jashtë shtetit (pasaportë) të lëshuar nga autoritetet përkatëse shqiptare; kartat e identitetit të Emirateve të Bashkuara Arabe do të jepen nga autoritetet e vendit. Anëtarët e forcës ushtarake shqiptare do t'ua paraqesin këto karta autoriteteve të duhura të Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, kur t'iu kërkohet.

#### Neni 12

Personeli i forcave ushtarake të Republikës së Shqipërisë nuk u nënshtrohet taksave dhe tarifave të tjera, si dhe inspektimeve dhe rregullave doganore, përfshirë paraqitjen e inventarëve ose dokumentacionin tjetër rutinë për doganat, personelin, automjetet, mjetet e lundrimit, ato të fluturimit, pajisjet, furnizimet që hyjnë, dalin ose kalojnë transit në territorin e Emirateve të Bashkuara Arabe nga/ose për llogari të forcave ushtarake të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të operacioneve që ato kryejnë.

#### Neni 13

Automjetet, mjetet lundruese dhe ato fluturuese të përdorura prej forcës ushtarake shqiptare nuk do t'i nënshtrohen licencimit apo regjistrimit sipas ligjit të Emirateve të Bashkuara Arabe. Forca shqiptare mund të përdorë komplekset aeroportuale, pa iu nënshtroar pagesave, taksave dhe detyrimeve të tjera. Anëtarët e forcës mund të drejtojnë automjete me dëshmi dhe identifikim ushtarak të vlefshëm shqiptar.

Personelit të forcave ushtarake të Republikës së Shqipërisë i garantohet përdorimi i aeroporteve, rrugëve, hekurudhave dhe porteve, pa paguar taksa ose detyrime që rrjedhin nga përdorimi i tyre. Megjithatë, personeli i forcave ushtarake të Republikës së Shqipërisë nuk do të kërkojë përjashtimin nga pagesat e arsyeshme për shërbime të veçanta të kërkuara dhe që i janë siguruar, por operacionet/lëvizja dhe aksesit nuk do të lejohen të pengohen për shkak të pagimit të këtyre shërbimeve.

#### Neni 14

Personeli i forcave ushtarake të Republikës së Shqipërisë do të përjashtohet prej tatimit nga Emiratet e Bashkuara Arabe mbi pagat dhe shpërblimet e marra nga personeli i palës shqiptare dhe mbi çdo të ardhur tjetër të marrë nga jashtë Republikës së Shqipërisë ose nga çdo vend tjetër

pjesëmarrës në operacion.

#### Neni 15

Personeli i forcave ushtarake të Republikës së Shqipërisë, si dhe pronat e tyre të patundshme të importuara, të blera apo të eksportuara nga Emiratet e Bashkuara Arabe nga ose në emër të personelit të palës shqiptare përjashtohen nga të gjitha taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera apo inspektime dhe detyrime doganore të Emirateve të Bashkuara Arabe.

#### Neni 16

Qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe mund të kërkojë në çdo kohë tërheqjen e forcës nga Emiratet e Bashkuara Arabe. Qeveria e Republikës së Shqipërisë rezervon të drejtën të tërheqë forcën shqiptare në çdo kohë, pasi të ketë njoftuar Qeverinë e Emirateve të Bashkuara Arabe.

#### Neni 17

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e njoftimit me shkrim të palës tjetër për përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi.

Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë 12-mujore dhe rinovohet automatikisht për periudha të ngjashme, me përjashtim të rastit kur njëra prej palëve njofton palën tjetër për synimin e saj të dhënies fund të kësaj Marrëveshjeje 6 muaj përpara periudhës së skadimit të saj, megjithatë kjo nuk cenon paragrafin 5, i cili do të zbatohet për çdo çështje, që mund të lindë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 18

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve, që do të lindë nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet ekskluzivisht nga Palët nëpërmjet konsultimit dhe negocimit.

Kjo Marrëveshje do të përfundohet në gjuhët shqipe, arabe dhe angleze, me tri tekste autentike. Në rast ndryshimesh, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

### **VENDIM**

**Nr.533, datë 22.8.2007**

### **PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “STEBLEVË”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Steblevë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 9 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Stebleva” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.534, datë 22.8.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “DARSI”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Darsi”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 9 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “KLENIS” sh.p.k.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.535, datë 22.8.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “PRELLË”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Prellë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 8 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “ENDI-E” sh.p.k.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.536, datë 22.8.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË KONKURRIMIT PËR DHËNIEN ME QIRA, ME ÇMIMIN SIMBOLIK NJË EURO, TË SIPËRFAQES 14 600 M<sup>2</sup>, TË UZINËS SË VJETËR TË**

## URESË, PËR NDËRTIMIN E NJË TERMOCENTRALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës publike, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

1. Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira, me çmimin simbolik një euro, të sipërfaqes 14 600 m<sup>2</sup>, ku përfshihen objektet, kulla e ftohjes, pompat e ujit, magazina e uzinës së vjetër të uresë, Fier, për ndërtimin e një termocentrali, të jenë sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Procedurat për dhënien me qira janë ato të përcaktuara në vendimin nr.162, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive apo institucioneve shtetërore”.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

### SHTOJCA NR.1

#### KRITERET E VLERËSIMIT TË OFERTAVE PËR DHËNIEN ME QIRA

|                                                                                                                                   | Përqindja e vlerësimit |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|
| a) Investimi                                                                                                                      | 10                     |
| b) Punësimi                                                                                                                       | 10                     |
| c) Kapaciteti i instaluar (në MW)                                                                                                 | 10                     |
| d) Disponibiliteti i impiantit (në përqindje)                                                                                     | 10                     |
| e) Sasia vjetore e prodhimit (në MWh)                                                                                             | 10                     |
| f) Çmimi i energjisë së ofruar për shitje (euro/MWh)                                                                              |                        |
| në kontratën e shitblerjes                                                                                                        | 40                     |
| g) Koha e fillimit të prodhimit të energjisë elektrike                                                                            | 10                     |
| - Afati maksimal për kontratën e shitblerjes së energjisë do të jetë 10 vjet.                                                     |                        |
| - Autoriteti kontraktues do të përcaktojë sasinë dhe fuqinë maksimale vjetore të energjisë për blerje në kontratën e shitblerjes. |                        |

### VENDIM Nr.537, datë 1.8.2007

#### PËR RREGULLAT PËR EMRAT DHE EMËRTIMET TREGTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 23 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

1. Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:

a) “Emri i personit juridik” është emri me të cilin personi juridik (përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja) është regjistruar në regjistrin tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të

Regjistrimit (në vijim QKR).

b) “Emërtimi i personit juridik” është emërtimi tregtar i personit juridik (përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja), që përdoret në kursin e tregut, e që mund të jetë i ndryshëm nga emri me të cilin është regjistruar në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, që mund të jetë pjesë ose akronim i emrit të regjistruar, i njoftuar vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

c) “Emri i personit fizik” është emri me të cilin individ i është regjistruar në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, në kuptim të nenit 5 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

ç) “Emërtimi i personit fizik” është emërtimi tregtar i personit fizik, regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKR-së, (sipas kërkesave të nenit 9 të ligjit nr.7632, datë 4.11.1992), që përdoret prej tij në kursin e tregut, i njoftuar vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në.

d) “Emërtimi i shoqërisë së thjeshtë” është emërtimi tregtar, që përdoret nga shoqëria e thjeshtë në kursin e tregut, e regjistruar në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, i njoftuar vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në.

dh) “Shenjat dalluese të veprimtarisë” janë shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë së subjektit, të regjistruara në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, që njoftohen vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në. Shembuj të këtyre shenjave dalluese janë: (i) markat e paregjistruara, tabelat (përfshi këtu elementet figurative, që dallojnë një veprimtari franchising); (ii) domain name (emri i domain-it në internet); (iii) logoja e simbolet e tjera, të përdorura gjatë ushtrimit të një veprimtarie ekonomike tregtare nga një subjekt i regjistruar e që dallojnë mallrat, shërbimet ose vendin e ushtrimit të kësaj veprimtarie.

e) “Markë e regjistruar” është marka tregtare ose e shërbimit, në kuptim të dispozitave të ligjit nr.7819, datë 27.4.1994 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, e regjistruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

ë) “Karakter dallues”, është elementi grafik, gjuhësor apo i një natyre tjetër, që dallon mjaftueshëm emrin e personit juridik, emërtimin e tij, emërtimin e personit fizik, të shoqërisë së thjeshtë, markën e regjistruar ose çdo shenjë tjetër dalluese të veprimtarisë (sipas përcaktimeve të këtij neni) të një subjekti të regjistruar në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, alternativisht në krahasim me emrin, emërtimin apo me shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë së një subjekti tjetër. Karakteri dallues mungon kur përdorimi i një emri, emërtimi apo i një shenje tjetër dalluese mund të sjellë paqartësi për publikun.

f) “Emër i njëjtë” është emri i një personi, juridik apo fizik, të regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKR-së, i cili është i njëjtë me emrin e një subjekti tjetër, të regjistruar.

g) “Emër i ngjashëm” është emri i një personi, juridik apo fizik, të regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKR-së, i cili nuk ka karakter dallues, në krahasim me emrin e një subjekti tjetër, të regjistruar.

gj) “Emërtim i njëjtë” është emërtimi i një personi juridik, i një personi fizik e i një shoqërie të thjeshtë (që njoftohet vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në), i cili është i njëjtë me emrin, emërtimin apo me shenjat e tjera dalluese të një subjekti tjetër, të regjistruar.

h) “Emërtim i ngjashëm” është emërtimi i një personi juridik, i një personi fizik e i një shoqërie të thjeshtë (që njoftohet vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në), i cili nuk ka karakter dallues në krahasim me emrin, emërtimin apo me shenjat e tjera dalluese të një subjekti tjetër, të regjistruar.

i) “Shenjë dalluese e njëjtë” është shenja dalluese, sipas përcaktimit të kësaj pike, që njoftohet vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në, e cila është e njëjtë me emrin, emërtimin apo me shenjat e tjera dalluese të një subjekti tjetër, të regjistruar.

j) “Shenjë dalluese e ngjashme” është shenja dalluese, sipas përcaktimit të këtij neni, që njoftohet vullnetarisht, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në, e cila nuk ka karakter dallues në krahasim me emrin, emërtimin apo me shenjat e tjera dalluese të një subjekti tjetër, të regjistruar.

2. Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, i personave juridikë, përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, të cilët aplikojnë për regjistrim fillestar, duke deklaruar një emër, të njëjtë apo të ngjashëm, me emrin e regjistruar apo të rezervuar më parë nga një

subjekt tjetër.

I njëjti ndalim zbatohet edhe në rastin e ndryshimit të emrit të personit juridik apo të rezervimit të emrit, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në.

3. Ndalimi, i parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi, nuk zbatohet në rastin kur titullari i ligjshëm i emrit të regjistruar apo të rezervuar më parë autorizon me shkrim, regjistrimin e emrit, që kërkohet të regjistrohet. Në këtë rast, emrit i shtohet një element me karakter dallues.

4. Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, i personave juridikë, përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, të cilët aplikojnë për regjistrim fillestar, duke deklaruar një emër, që mund të cenojë apo që është në kundërshtim me rendin publik, të tillë si emra që mund të nxisin apo përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, dhunën, emra që mund të prishin ekuilibrin shoqëror, që garanton dhe mbron tërësinë e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, drejtësinë shoqërore, rendin kushtetues, pluralizmin, identitetin kombëtar, trashëgiminë kombëtare, bashkëjetesën fetare e etnike, si dhe emra që bien në kundërshtim me rendin publik, në çdo kuptim tjetër, që mund t'i jepet këtij termi nga legjislacioni në fuqi.

I njëjti ndalim zbatohet edhe në rastin e ndryshimit të emrit të personit juridik apo të rezervimit të emrit, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në.

5. Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, i personave juridikë, përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, të cilët aplikojnë për regjistrim fillestar, duke deklaruar një emër, që mund të cenojë apo që është në kundërshtim me moralin publik, kuptuar si tërësia e vlerave morale e shoqërore të popullit shqiptar, të respektit ndaj dinjitetit njerëzor e familjes, emra me karakter fyes e të turpshëm, si dhe emra, që bien në kundërshtim me moralin publik, në çdo kuptim tjetër, që mund t'i jepet këtij termi nga legjislacioni në fuqi.

I njëjti ndalim zbatohet edhe në rastin e ndryshimit të emrit të personit juridik apo të rezervimit të emrit, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në.

6. Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, i personave juridikë, përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, të cilët aplikojnë për regjistrim fillestar, duke deklaruar, për efekt regjistrimi, emra në trajtën e shquar apo akronimet përkatëse, të shteteve, qyteteve, krahinave gjeografike, organizatave ndërkombëtare, fetare apo institucioneve të pushtetit, qendror a vendor, pa shtesa me karakter dallues.

7. Ndalohet regjistrimi në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, i personave juridikë, përfshirë degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja, të cilët aplikojnë për regjistrim fillestar, duke deklaruar një emër, që, shprehimisht, ndalohet nga një dispozitë urdhëruese e ligjit.

8. Ndalimet e përcaktuara në pikat 6 e 7 të këtij vendimi, zbatohen dhe në rastin e ndryshimit të emrit të personit juridik apo për rezervimin e emrit, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në.

9. Ndalimet, e përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, nuk zbatohen në rastin kur titullari i institucionit ka dhënë me shkrim, miratimin për përdorimin e emrit dhe emrit, që kërkohet të regjistrohet, i është shtuar një element me karakter dallues.

10. Personi fizik regjistrohet në regjistrin tregtar, pranë QKR-së, me emrin dhe mbiemrin e plotë, që rezulton nga dokumentet e identifikimit.

11. Për miratimin e aplikimit për regjistrim, ndryshim apo rezervim të emrit të personit juridik, nëpunësi i autorizuar i QKR-së:

a) verifikon, në bazën e të dhënave elektronike të QKR-së, nëse emri, që kërkohet të regjistrohet apo rezervohet, është i njëjtë apo i ngjashëm me emrat e regjistruar apo të rezervuar më parë nga një subjekt tjetër dhe vlerëson, në bazë të rezultatit të kërkimit, karakterin dallues të emrit, që kërkohet të regjistrohet apo të rezervohet;

b) verifikon nëse emri i personit juridik, që kërkohet të regjistrohet apo rezervohet, bie në kundërshtim me ndalimet e përmendura në pikat 4 deri 9 të këtij vendimi.

12. Nëse pas verifikimeve, nëpunësi i autorizuar i QKR-së vëren se emri i personit juridik, që kërkohet të regjistrohet ose rezervohet, është i njëjtë me emrin e një personi fizik, të regjistruar më parë, është i njëjtë apo pa karakter dallues me emrin e një personi juridik, të regjistruar apo rezervuar më parë, ose bie në kundërshtim me ndalimet e përcaktuara në pikat 4 deri 9 të këtij vendimi, brenda afatit të parashikuar në nenin 55 të ligjit për QKR-në, vendos që emri të mos regjistrohet apo rezervohet dhe vepron në përputhje me vendimin nr.506, datë 1.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e regjistrimit dhe të publikimit në QKR”. Nëse këto vërehen gjatë shqyrtimit të aplikimit

për rezervim emri, QKR-ja refuzon menjëherë regjistrimin.

13. Kur emri i personit juridik, që kërkohet të regjistrohet ose rezervohet, është i njëjtë me emrin e një personi fizik, të regjistruar më parë, QKR-ja pranon regjistrimin kur personi fizik i interesuar ka dhënë me shkrim, miratimin për përdorimin e emrit. Në këtë rast, emrit të personit juridik, që kërkohet të regjistrohet, i shtohet një element me karakter dallues. Autorizimi me shkrim nuk nevojitet, kur regjistrimi apo rezervimi i emrit kryhet nga vetë personi fizik, i interesuar.

14. Ndaj vendimit të QKR-së, subjekti, të cilit i është refuzuar regjistrimi i emrit, ka të drejtë të ankohet, në rrugë administrative, brenda afateve ligjore, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Ndaj vendimit përfundimtar të ankimit në rrugë administrative, ky subjekt, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile e brenda afateve ligjore, mund të ankohet në rrugë gjyqësore.

15. Çdo person i interesuar, në përputhje me ligjin për QKR-në dhe Kodin e Procedurave Administrative, ka të drejtë, brenda afateve ligjore, të ankohet, në rrugë administrative ndaj vendimit të QKR-së, për regjistrimin e emrit të personit juridik në shkelje të dispozitave të pikave 2 deri 9 të këtij vendimi.

Ndaj vendimit përfundimtar të ankimit në rrugë administrative, personi i interesuar, brenda afateve, mund të ankohet në rrugë gjyqësore, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

16. Ndalohen njoftimi dhe botimi nga regjistri tregtar i emërtimeve apo shenjave të tjera dalluese të veprimtarisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, të cilat mund të cenojnë apo të jenë në kundërshtim me rendin publik, të tilla si emërtime apo shenja, që mund të nxisin a përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, dhunën, emërtime apo shenja, që mund të prishin ekuilibrin shoqëror, që garanton dhe mbron tërësinë e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, drejtësinë shoqërore, rendin kushtetues, pluralizmin, identitetin kombëtar, trashëgiminë kombëtare, bashkëjetesën fetare e etnike, si dhe emërtime apo shenja, që bien në kundërshtim me rendin publik, në çdo kuptim tjetër, që mund t'i jepet këtij termi nga legjislacioni në fuqi.

17. Ndalohen njoftimi dhe botimi nga regjistri tregtar, pranë QKR-së, i emërtimeve apo shenjave të tjera dalluese të veprimtarisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, të cilat mund të cenojnë apo mund të jenë në kundërshtim me moralin publik, kuptuar si tërësia e vlerave, morale e shoqërore, të popullit shqiptar, të respektit ndaj dinjitetit njerëzor e të familjes, emra me karakter fyes e të turpshëm, ose çdo kuptim tjetër, që mund t'i jepet këtij termi nga legjislacioni në fuqi.

18. Ndalohen njoftimi dhe botimi nga regjistri tregtar, pranë QKR-së, i emërtimeve apo shenjave të tjera dalluese të veprimtarisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, të cilat ndalohen, shprehimisht, nga një dispozitë urdhëruese e ligjit.

19. QKR-ja, për pranimin e aplikimit për publikim të emërtimeve apo shenjave dalluese, sipas shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në, verifikon nëse emërtimi apo shenjat dalluese bien në kundërshtim të dukshëm me ndalimet e përcaktuara në pikat 16 deri 18 të këtij vendimi.

20. Nëse nëpunësi i autorizuar, pas verifikimeve të sipërpërmendura, vëren se emërtimi apo shenjat dalluese bien në kundërshtim me rregullat e parashikuara në pikat 16 deri 18 të këtij vendimi, QKR-ja refuzon publikimin.

21. Subjekti, të cilit i është refuzuar publikimi i emërtimeve apo i shenjave, ka të drejtë, që, brenda afateve ligjore, të ankohet në rrugë administrative ndaj vendimit, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në dhe të Kodit të Procedurave Administrative.

Ndaj vendimit përfundimtar të ankimit në rrugë administrative, subjekti, brenda afateve ligjore, mund të ankohet në rrugë gjyqësore, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

22. Çdo person i interesuar, në përputhje me dispozitat e ligjit për QKR-në dhe të Kodit të Procedurave Administrative, ka të drejtë të ankohet, brenda afateve ligjore, në rrugë administrative, ndaj vendimit të QKR-së për publikimin e emërtimeve apo të shenjave dalluese, në shkelje të dispozitave të pikave 16 deri 18 të këtij vendimi, si dhe në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, mund të ankohet, brenda afateve ligjore, në rrugë gjyqësore ndaj vendimit përfundimtar të ankimit në rrugë administrative.

23. Gjatë përcaktimit të përputhshmërisë së emrit, emërtimeve apo shenjave dalluese, QKR-ja kryen vlerësimin e përputhshmërisë së emrit, emërtimeve apo shenjave, duke marrë parasysh tërësinë e tyre.

24. Regjistrimi i emrit të personit juridik i jep subjektit të drejtën ta përdorë atë në kursin e

tregut, si dhe të pengojë përdorimin e tij, në mënyrë të padrejtë, nga të tretët.

25. Regjistrimi i emrit të personit juridik nuk përbën pengesë për regjistrimin nga të tretët të një shenje të ngjashme apo të njëjtë me të, si markë tregtare apo shërbimi, përveç rastit kur, në përputhje me legjislacionin për pronësinë industriale, përdorimi i emrit në kursin e tregut ka efekt pengues ndaj këtij regjistrimi.

26. Çdo person i interesuar mund të kërkojë, në rrugë gjyqësore, ndalimin e përdorimit apo çregjistrimin e emrit të personit juridik, nëse ai cenon të drejtën e emrit, sipas nenit 5 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

27. Çdo person i interesuar mund të kërkojë, në rrugë gjyqësore, ndalimin e përdorimit apo çregjistrimin e emrit të personit juridik, nëse ai cenon një të drejtë, sipas legjislacionit për të drejtën e autorit.

28. Çdo person i interesuar, në bazë të nenit 638 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë e të dispozitave, që rregullojnë pronësinë industriale, mund të kërkojë, në rrugë gjyqësore, ndalimin e përdorimit apo çregjistrimin e emrit të personit juridik, nëse ai cenon një markë të regjistruar më parë apo emrat, emërtimet tregtare e shenjat dalluese të përdorura ligjërisht më parë nga të tretët (pavarësisht publikimit të tyre në regjistrin tregtar, sipas ligjit për QKR-në).

29. Çdo person i interesuar mund të kërkojë, në rrugë gjyqësore, ndalimin e përdorimit apo çregjistrimin e emrit të personit juridik, nëse ai, sipas legjislacionit në fuqi, cenon një të drejtë tjetër të të tretëve.

30. Publikimi i emërimit apo i shenjave dalluese të veprimtarisë, të njoftuar vullnetarisht, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 44 të ligjit për QKR-në, ka efekt deklarativ.

31. Çdo person i interesuar, në përputhje me nenin 638 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, me dispozitat, që rregullojnë pronësinë industriale dhe të drejtën e autorit, e në rastet e parashikuara prej këtyre dispozitave a dispozitave të tjera ligjore, ka të drejtë të ankohet, në rrugë gjyqësore, ndaj përdorimit të paligjshëm në kursin e tregut të emërimit apo të shenjave dalluese të veprimtarisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.541, datë 22.8.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KALIMIT NË PRONËSI TË TROJEVE, MBI TË CILAT JANË BËRË NDËRTIME TË LIGJSHME, PARA DATËS 10.8.1991 DHE TË SIPËRFAQEVE, NË DOKUMENTIN E PRONËSISË SË TË CILAVE ËSHTË BËRË SHËNIMI “OBORR NË PËRDORIM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 3 dhe 23, pika 1, të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar dhe të neneve 24, shkronja “c”, e 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Institucionet e autorizuar për trajtimin dhe shqyrtimin e kërkesave janë zyra qendrore e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim AKKP-ja) dhe zyrat rajonale të AKKP-së në qarqe.

2. Trojet, mbi të cilat janë bërë ndërtime të ligjshme, para datës 10.8.1991 dhe sipërfaqet, në dokumentin e pronësisë së të cilave është bërë shënimi “oborr në përdorim”, të kalojnë në pronësi të pronarëve të ndërtësive, pasi të paguajnë vlerën fillestare të truallit, sipas nenit 10 të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, shumëzuar me indeksin e rritjes së çmimeve, sipas tabelës në shtojcën nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Pagesat të kryhen pranë zyrave rajonale të AKKP-së në qark dhe të derdhen në Buxhetin e Shtetit, në “Fondi i kompensimit të

pronave”.

3. Sipërfaqet e trojeve, që do të trajtohen sipas pikës 2 të këtij vendimi, nuk duhet të kenë qenë më parë objekt trajtimi nga AKKP-ja ose ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave.

4. Personat, që zotërojnë troje dhe sipërfaqe, sipas përcaktimit të këtij vendimi, krahas kërkesës, sipas formularit tip, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, drejtuar zyrës rajonale të AKKP-së, në qark, duhet të paraqesin edhe dokumentet e mëposhtme:

a) vërtetimin e pronësisë së ndërtesës dhe/ose dokumentin e pronësisë së sipërfaqes përreth saj, për të cilën është bërë shënimi “oborr në përdorim”;

b) deklaratën noteriale për kufijtë e pronës së pronarëve kufitarë, kur kjo është e mundur. Kur në kufi të kësaj prone janë prona shtetërore, konfirmimin nga bashkia apo komuna përkatëse;

c) planvendosjen e sipërfaqes në përdorim dhe të ndërtesës në pronësi, që gjendet mbi të, të siguruar, sipas përcaktimeve në shkronjën “b” të pikës 3 të kreut I të vendimit nr.747, datë 9.11.2006 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës”;

ç) dokumentacion nga Arkivi Teknik i Ndërtimit, që vërteton se ndërtimi është bërë para datës 10.8.1991;

d) dokumente të tjera mbështetëse, nëse ka, si:

i) aktin e marrjes në përdorim të truallit;

ii) regjistrimin përkatës kadastral pranë zyrave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës, në këshillin e qarkut;

iii) dokumentin nga arkiva hipotekore, pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe/ose certifikatën e pronësisë për ndërtesën;

iv) dokumentin nga Arkivi i Shtetit Shqiptar, kur dokumentet, hipotekore apo kadastrale, janë të depozituara atje;

v) lejen e ndërtimit, dhënë nga organi përgjegjës në periudhën, kur është bërë ndërtimi;

vi) vendimin gjyqësor të vërtetimit të faktit të periudhës, kur është bërë ndërtimi;

vii) dokumente të tjera gjyqësore, si p.sh. aktinjoftunitë;

viii) të dhëna të dokumentuara nga organet e pushtetit, (lagjja ose rrethi);

ix) dokumentet, që vërtetojnë blerjen e truallit nga ish-pronarët;

x) dokumentet e trashëgimisë të personave të interesuar;

xi) akte të tjetërsimit të trojeve shtetërore dhe lejet përkatëse të tjetërsimit, të lëshuara nga organi përgjegjës në kohën e kryerjes së tjetërsimit.

5. Zyra rajonale e AKKP-së, në qark, verifikon vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga kërkuuesi, si dhe mund të kërkojë dokumente të nevojshme, nga institucione të treta, për vërtetimin e gjendjes, juridike apo fizike, të trojeve në përdorim, si dhe konfirmimin e dokumentacionit tekniko-ligjor.

6. Zyrat rajonale të AKKP-së, në qarqe, për dhënien e vendimit për kalimin në pronësi të sipërfaqeve, objekt i këtij vendimi, mbështeten në:

a) dokumentacionin tekniko-ligjor, që përcakton sipërfaqen e trojeve, të marra për ndërtim, dhe që mundëson përcaktimin e sipërfaqes së pazënë nga ndërtimi;

b) dokumentacionin tekniko-ligjor, që përcakton kufijtë e truallit, të zënë nga ndërtimi dhe të oborrit në përdorim.

7. Në shqyrtimin e kërkesave dhe dhënien e vendimit për kalimin në pronësi, zyra rajonale e AKKP-së, në qark, kryen këto veprime:

a) Në rastet kur kufijtë rezultojnë të saktë, AKKP-ja merr vendim për kërkesën, në bazë të kufijve të përcaktuar dhe sipërfaqes, sipas dokumentacionit tekniko-ligjor, pasi ka përcaktuar vlerën, që do të paguajë kërkuuesi. Në rastet kur sipërfaqja e truallit nën ndërtesë dhe/ose përreth saj nuk përcaktohet sipas dokumentacionit tekniko-ligjor, zyra rajonale e AKKP-së, në qark, bën matjen në terren;

b) Në të gjitha rastet kur rezulton se kufijtë nuk janë të përcaktuar ose kur dokumentacioni tekniko-ligjor nuk është i plotë, zyra rajonale e AKKP-së, në qark, bën përcaktimin e kufijve dhe të sipërfaqes, pasi ka bërë matjen në terren, duke përcaktuar sipërfaqen e truallit përreth ndërtesës, sipas shtojcës nr.1;

c) Vendimi për kalimin në pronësi, pa cenuar, në asnjë rast, të drejtat e pronësisë të të tretëve,

merret për sipërfaqen e truallit në ndërtesë dhe për sipërfaqen në dokumentin e pronësisë së të cilave është bërë shënimi “oborr në përdorim”, por në çdo rast, sipërfaqja e përgjithshme nuk duhet të kalojë sipërfaqen maksimale të lejueshme, sipas akteve, ligjore e nënligjore, në fuqi, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ç) Sipërfaqe trualli, në dokumentin e pronësisë së të cilës është bërë shënimi “oborr në përdorim”, do të jetë vetëm sipërfaqja, që rezulton fizikisht e lirë dhe e pazënë nga ndërtime të lejuara, sipas kuadrit ligjor përkatës. Sipërfaqet e truallit, të zëna me ndërtime pa leje, vlerësohen të lira.

8. Administrimi i kërkesave, afatet e shqyrtimit, ankimi ndaj vendimeve të zyrave rajonale të AKKP-së, në qarqe, procedurat, afatet e komunikimit ndërmjet AKKP-së dhe institucioneve shtetërore dhe raportimi i strukturave të AKKP-së rregullohen, në përputhje me aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e AKKP-së.

9. Kërkuesit duhet t’i paraqesin kërkesat e tyre deri më 31.12.2007. Pas kalimit të këtij afati, AKKP-ja nuk pranon më kërkesa.

10. Forma e vendimit të zyrave rajonale të AKKP-së, në qarqe, dhe i zyrës qendrore të AKKP-së përcaktohet sipas modeleve në shtojcat 2 e 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

11. Ndërtimet informale, të bëra mbi sipërfaqet e “oborreve në përdorim” nuk janë objekt shqyrtimi nga AKKP-ja dhe trajtohen sipas akteve, ligjore e nënligjore, në fuqi.

12. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

#### SHTOJCA NR. 1

#### MASAT E SIPËRFAQEVE TË NDËRTIMEVE DHE OBOREVE NË PËRDORIM SIPAS PERIUDHAVE

| PERIUDHA                                | SIPËRFAQJA<br>(Tokë/truall) në m <sup>2</sup>                                                                                                                                                       | REFERENCA LIGJORE                                     |
|-----------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|
| Deri në datën<br>16.8.1961              | Deri në 500                                                                                                                                                                                         | Neni 4 i VKM 185/1956 dhe neni 1 i<br>UKM 11/1957     |
| Nga data 16.8.1961<br>deri në 22.7.1978 | 150-200                                                                                                                                                                                             | Neni 31 i VKM 282/1961<br>Neni 1 i dekretit 4824/1971 |
| Nga data 22.7.1978<br>deri në 8.1.1986  | - Deri në 200 m <sup>2</sup> në fshatrat fushore<br>- Deri në 300 m <sup>2</sup> në fshatrat kodrinore e<br>malore<br>- 140 - 170 m <sup>2</sup> në qytete                                          | Neni 10 i dekretit 5747/1978                          |
| Nga data 8.1.1986<br>deri në 10.8.1991  | - Deri në 200 m <sup>2</sup> në fshatrat fushore<br>- Deri në 250 m <sup>2</sup> në fshatrat kodrinore<br>- Deri në 300 m <sup>2</sup> në fshatrat malore<br>- Deri në 150 m <sup>2</sup> në qytete | Neni 6 i dekretit 7011/1985                           |



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E DREJTËSISË**  
**AGJENCIA E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE**  
**ZYRA RAJONALE E QARKUT**

Adresa:

Tel.

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë, \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

**VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë, \_\_\_\_\_

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË \_\_\_\_\_**

(përshkrim i truallit që kalon në pronësi si  
dhe gjeneralitetet e subjektit përfitues)

Sot më datë \_\_\_\_\_, në mbështetje të nenit 8 pika 3 të ligjit nr. 9235 datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar dhe shkronjës “c” të nenit 24 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, të vendimit nr. ...., datë ..... të Këshillit të Ministrave, në cilësinë e Drejtorit të Zyrës Rajonale të Qarkut \_\_\_\_\_, mora në shqyrtim kërkesën nr. \_\_\_\_\_ prot, datë \_\_\_\_\_, që i përket subjektit

**Kërkues:** \_\_\_\_\_

*(Gjeneralitetet e subjektit kërkues, si dhe adresa e deklaruar. Në rastin e trashëgimtarëve përcaktoni numrin dhe datën e dëshmisë së trashëgimisë.)*

**Me objekt:** \_\_\_\_\_

*(Objekti i kërkesës së subjektit, si dhe baza ligjore e saj.)*

Pasi shqyrtova kërkesën e subjektit, dokumentacionin bashkëlidhur saj, materialet shkresore të ndodhura në dosjen nr. .... prot., datë ....., ato të krijuara nga korrespondenca me institucionet e tjera, dhe pasi kreu veprimet e nevojshme procedurale \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
*(si këqyrje, matje, konfirmime etj.)*

në zbatim të ligjit nr. 9235 datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar,

**VËREJ SE:**

**I. FAKTET MBI TË CILAT MBËSHTETET KËRKESA**

*(Pasqyroni në mënyrë të qartë të gjitha faktet që paraqiten në dosjen përkatëse, dokumentacionin që e shoqëron, lidhjen gjinore që ka me subjektin etj.)*



---

---

---

---

---

---

---

---

**PËR KËTO ARSYE,**

bazuar në sa më sipër, dhe në mbështetje të nenit 8 pika 3 të ligjit nr. 9235 datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" i ndryshuar dhe shkronjës "c" të nenit 24 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar, në cilësinë e Drejtorit të Zyrës Rajonale të AKKP-së të Qarkut \_\_\_\_\_,

**VENDOSA:**

a) Kalimin në pronësi të truallit

---

---

*(përshkrim i plotë dhe i saktë i truallit me sipërfaqen e kufizimet përkatëse sipas dokumentacionit ligjor),*

subjektit

*(Gjeneralitetet e subjektit. Në rastin e trashëgimitarit/ëve ligjor të tij të përmendet edhe numri e data e dëshmisë së trashëgimisë dhe pjesët takuese të gjithsecilit të renditura sipas dëshmisë së trashëgimisë),*

---

---

b) Këtij vendimi i bashkëlidhet planvendosja sipas shenjave konvencionale përkatëse.

c) Vendimi hartohet në (6) kopje.

*(2 kopje qëndrojnë në protokollin e institucionit, 1 kopje i jepet menjëherë kërkuesit nga zyra e protokollit, 1 kopje dërgohet në Zyrën Qendrore të AKKP-së, 1 kopje dërgohet në ZRPP, si dhe 1 kopje pranë Avokaturës së Shtetit.)*

ç) Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të tij pranë Zyrës Qendrore të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Tiranë.

U shpall sot më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_.

**Drejtori i Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave  
Qarku \_\_\_\_\_**

*(Emër, mbiemër, firmë, vulë)*

Shënim: Ky vendim përbën titull ekzekutiv nga data \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_  
Drejtori i Zyrës Rajonale të AKKP-së, të Qarkut

*(emër, mbiemër, firmë, vulë)*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË

AGJENCIA E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Adresa:

Tel.

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë, \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

**VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë, \_\_\_\_\_

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË**

(përshkrim i trullit që kalon në pronësi si dhe gjeneralitetet e subjektit përfitues)

Sot më datë \_\_\_\_\_, në mbështetje të nenit 8 pika 3 të ligjit nr. 9235 datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar dhe shkronjës “c” të nenit 24 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, të vendimit nr. ...., datë ..... të Këshillit të Ministrave, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, mora në shqyrtim ankesën nr. \_\_\_\_\_ prot, datë \_\_\_\_\_ që i përket subjektit

**Ankues:** \_\_\_\_\_

(Gjeneralitetet e subjektit ankues, si dhe adresa e deklaruar. Në rastin e trashëgimtarëve përcaktoni numrin dhe datën e dëshmisë së trashëgimisë.)

**Me objekt:** \_\_\_\_\_

(Objekti i ankimit të subjektit, si dhe baza ligjore e saj.)

Pasi shqyrtova ankesën e subjektit, dokumentacionin bashkëlidhur saj, materialet shpresore të ndodhura në dosjen nr. .... prot., datë ....., ato të krijuara nga korrespondenca me institucionet e tjera, dhe pasi kreu veprimet e nevojshme procedurale \_\_\_\_\_

(si këqyrje, matje, konfirmime etj.)

në zbatim të ligjit nr. 9235 datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar,

**VËREJ SE:**

**I. FAKTET MBI TË CILAT MBËSHTETET KËRKESA**

(Pasqyroni në mënyrë të qartë të gjitha faktet që paraqiten në dosjen përkatëse, dokumentacionin që e shoqëron, lidhjen gjinore që ka me subjektin etj.)

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

[illegible]

## II. LIGJI I ZBATUESHËM

(Citoni në mënyrë taksative dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore ku do të mbështeteni për të dhënë vendimin duke shkruar të gjitha pjesët e këtyre dispozitave.)

[illegible]

### **III. ANALIZA LIGJORE E FAKTEVE**

*(Paraqisni të gjitha argumentet dhe arsyetimin tuaj në lidhje me mbështetjen ose jo në ligjin e zbatueshëm të fakteve të parashtruara në ankesën e subjektit.)*

[illegible]

#### IV. KONKLUZIONI

*(Paraqisni një konkluzion të shkurtër nëse e pranoni ose jo ankesën, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, pas analizës ligjore të fakteve që keni bërë.)*

[illegible]

**PËR KËTO ARSYE,**

bazuar në sa më sipër, dhe në mbështetje të nenit 8 pika 3 të ligjit nr. 9235 datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar, dhe shkronjës "c" të nenit 24 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së,

**VENDOSA:**

*(një nga rastet e mëposhtme)*

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ të Zyrës Rajonale të Qarkut \_\_\_\_\_.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ të Zyrës Rajonale të Qarkut \_\_\_\_\_ dhe zgjidhjen në themel si më poshtë:

a)                      Kalimin                      në                      pronësi                      të                      truallit

\_\_\_\_\_  
*(përshkrim i plotë dhe i saktë i truallit me sipërfaqen e kufizimet përkatëse sipas dokumentacionit ligjor),*

subjektit

\_\_\_\_\_  
*(Gjeneralitetet e subjektit. Në rastin e trashëgimitarit/ëve ligjor të tij të përmendet edhe numri e data e dëshmisë së trashëgimisë dhe pjesët takuese të gjithsecilit të renditura sipas dëshmisë së trashëgimisë),*

\_\_\_\_\_  
3. Këtij vendimi i bashkëlidhet planvendosja sipas shenjave konvencionale përkatëse.

4. Vendimi hartohet në 5 kopje.

*(2 kopje qëndrojnë në protokollin e institucionit, 1 kopje i jepet menjëherë kërkuesit nga zyra e protokollit, 1 kopje dërgohet në ZRPP, si dhe 1 kopje në Avokaturën e Shtetit.)*

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë gjykatës së rrethit gjyqësor \_\_\_\_\_, brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ dhe hyn në fuqi menjëherë.

**Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**

\_\_\_\_\_  
*(Emër, mbiemër, firmë, vulë)*

#### **SHTOJCA 4**

Indeksi mesatar i rritjes së çmimeve

| Viti | 1995 | 1996 | 1997 | 1998 | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003  | 2004  | 2005  | 2006  |
|------|------|------|------|------|------|------|------|------|-------|-------|-------|-------|
| IRrÇ | 50,5 | 56,9 | 75,8 | 91,5 | 91,8 | 91,9 | 94,7 | 99,7 | 102,0 | 104,9 | 107,4 | 110,0 |

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)**  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## **BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

## **BOTIME TË REJA** *(Të përditësuara gusht 2007)*

**KODI PENAL**

**KODI I PROCEDURËS PENALE**

### ***Së shpejti në treg:***

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 6.9.2007  
Doli nga shtypi më 8.9.2007

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 3500 copë | Formati: 61x86/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja "Nënë Tereza"  
Tiranë, 2007

Çmimi 28 lekë